




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Institucioni i Avokatit të Popullit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të IAP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

AP është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, AP është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

AP është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucioni i Avokatit të Popullit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Institucioni i Avokatit të Popullit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Institucioni i Avokatit të Popullit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislativi i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Institucioni i Avokatit të Popullit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit kemi vërejtur se procesi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ishte përcjellë me mangësi në ekzekutimin e pagesave për mallra dhe shërbime si dhe dobësi në procesin e menaxhimit të pasurisë. Mangësitë e identifikuara janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tre rekomandime të reja, nuk kemi pasur rekomandime tjera (të përsëritura apo pjesërisht të përsëritura) pasi që raporti i auditimit të PVF nga viti i kaluar nuk ka as një rekomandim.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe komunalitë në vitin 2021 ishte 236,422€, prej tyre ishin shpenzuar 186,720€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizim me pajisje të IT (lloptop), karburant për vetura, furnizime për zyre, dreka zyrtare, shpenzime të udhëtimeve zyrtare brenda vendit etj. Kemi testuar 15 mostra për teste substanciale në vlerë 50,216€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Pranimi i mallrave pa komision të pranimit

Gjetja Neni 8 pika 4 e Rregullës Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, përcakton se, Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim duhet të formojë Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare, i cili ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar si dhe të dokumentuar me procesverbal e që janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhër blerjen. Më tej, pika 5 thotë që Komisioni për Pranimin e Pasurisë jo Financiare duhet të jetë në përbërje jo më pak se tre (3) anëtar nga ekspertë të fushës përkatëse, duke përfshirë edhe zyrtarin me përgjegjësi materiale. Anëtar të këtij komisioni në rast nevojë mund të jenë edhe ekspertë të jashtëm.

Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në tri raste në vlerë 22,949€, IAP nuk kishte formuar komision të pranimit të mallrave/ furnizimeve. Pagesat kishin të bënin me “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative”, “Shërbime të shtypjes së raporteve vjetore” dhe “Furnizim me material mbrojtës kundër Covid-19”. Pasi që Zyrtari Kryesor Administrativ nuk kishte formuar komision të pranimit, mallrat ishin pranuar nga menaxherët e kontratave përkatëse. Në mungesë të komisionit për pranimin e mallrave, të njëjtat (mallrat) ishin pranuar nga menaxherët e kontratave përkatëse.

Kjo ka ndodhur për shkak se zyrtari kryesor administrative nuk e ka konsideruar të nevojshme formimin e komisionit për pranimin e mallrave/furnizimeve, me arsyetimin që mallrat hyjnë drejt për drejt në depo.

Lidhur me këtë, IAP ka kërkuar opinion ligjor tek Departamenti/Zyra Ligjore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për nenin 8 të Rregullës Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare. Sipas opinionit të tyre, në situatat e përcaktuara të nenit 8, pika 2 e Rregullores Nr. 02/2013 (pranimit i pasurisë në depo qendrore), nuk ka nevojë të formohet komision për pranimin e mallrave. Pavarësisht nga kjo, me qëllim të forcimit të kontrolleve të brendshme të OB-së, në vlerësojmë që pranimit i mallrave të bëhet nga komisionet përkatëse, kryesisht kur mallrat janë të natyrës specifike siç janë pajisjet e IT dhe tjera të ngjashme. Më tej, edhe në kushtet e veçanta të kontratës “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative”, kërkohej që pagesa të bëhej pas pranimit të mallrave me komision të pranimit.

Ndikimi Pranimi i mallrave/furnizimeve në mungesë të komisionit përkatës për pranimin e tyre, e rrit rrezikun e pranimin të mallrave/furnizimeve jo sipas llojit, sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.

Rekomandimi A1 Avokati i Popullit, duhet të sigurojë që komisionet përkatëse për pranimin e mallrave/furnizimeve janë caktuar me kohë dhe se të gjitha pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimin nga komisionet përkatëse sipas rregullave të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pagesa për dreka zyrtare pa dëshmi të duhura

Gjetja Neni 5 të Vendimit nr. 247/ 2019 (dt. 04.11.2019) për caktimin e të drejtës dhe të shumës mujore të reprezentacionit për zyrtarët e IAP-së, përcakton që shpenzimet e reprezentacionit përdoren vetëm për mbulimin e shpenzimeve të cilat bëhen me rastin e kryerjes së detyrave zyrtare, aktiviteteve dhe takimeve të ndryshme të punës me karakter zyrtar, dhe nuk mund të përdoren për nevoja e qëllime të tjera.

Në shtatë raste shpenzime “Dreka Zyrtare” në vlerë prej 278.50€, IAP nuk ka mundur të ofroj dëshmi që këto shpenzime ishin përdorur për qëllime të kryerjes së detyrave zyrtare, aktiviteteve dhe takimeve të ndryshme të punës me karakter zyrtar.

Kjo kishte ndodhur për shkak se nuk është respektuar vendimi me të cilin rregullohen shpenzimet e reprezentacionit për zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndikimi Mosrespektimi i kërkesave të vendimit për shpenzimet e reprezentacionit në IAP, ka ndikuar në realizimin e shpenzimeve të pa arsyeshme.

Rekomandimi A2 Avokati i Popullit, duhet të identifikoj shkaktarët e mos respektimit të vendimit për shpenzimet e reprezentacionit dhe të siguroj kontrolle adekuate në mënyrë që mangësitë e tilla të mos ndodhin në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 75,739€, pasurive jokapitale 89,543€, si dhe e stoqeve 11,850€. Ne kemi testuar 10 mostra për teste substanciale në vlerë 59,019€, si dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Sipas rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 4 paragrafi 4 ka përcaktuar se mënyra e ngarkimit dhe shkarkimit të zyrtarëve për menaxhim dhe përdorim të pasurisë jo financiare duhet të jetë përcaktuar në mënyrë të qartë me rregulla dhe procedura të brendshme të aprovuara nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore. Gjithashtu paragrafi 3 përcakton se të gjithë zyrtarët e organizatës buxhetore janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë që është në posedim dhe për mbikëqyrje të tij kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre sipas përgjegjësisë që i përfshin fushëveprimi; dhe

Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6 paragrafi 1 definon se çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj.

Në menaxhimin e pasurive kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Institucioni i IAP nuk kishte një rregullore të brendshme për menaxhimin e pasurisë që do të rregullonte mënyrën e ngarkimit dhe shkarkimit të zyrtarëve për përdorimin dhe menaxhimin e pasurisë.

Gjatë testimit të pasurisë ne vërejtëm se në regjistrin e pasurisë SIMFK (pasuria mbi 1,000€) pasuria me emërtim "Notebook Computer" me vlerë fillestare 1,290€ dhe vlera në libër zero, sipas përshkrimit të gjendjes së pasurisë e cila figuron se është në përdorim mirëpo me ekzaminimin fizik rezultojë që pajisja nuk ekziston. (Zyrtari i IAP-së, nuk e ka kthyer pas përfundimit të mandatit).

Gjithashtu, sipas zyrtarëve përgjegjës në IAP, ekzistojnë edhe dy raste të ngjashme të cilët zyrtarët e IAP-së nuk e kanë kthyer pasurinë/Laptopët pas përfundimit të mandatit të përfunduar në IAP. Vlera e njërit Laptop në libra më 31.12.2021 ishte 205.65€, ndërsa laptopi tjetër kishte vlerën zero.

Me datë 27.09.2021 Sekretari përgjithshëm kishte marrë vendim mbi bazën e rekomandimit të komisionit për tjetërsimin e pasurisë nën 1000 euro për dhurimin e pasurive jo financiare të IAP-së drejtorisë së arsimit të Komunës së Prishtinës. Ne identifikuam se pasuritë e dhuruara edhe pse ishin të dëmtuara dhe jo funksionale (vlera e tyre ishte zero), të njëjtat nuk ishin larguar nga regjistrat e pasurisë jo-financiare.

Nga testimi i regjistrit të pasurive nën 1,000€, kemi vërejtur që zhvlerësimi nuk ishte kalkuluar për furnizimet e reja gjatë vitit 2021. Vlera e zhvlerësimit të pa aplikuar është 1,979.87 euro. Për këtë vlerë është mbivlerësuar pasuria në fund të vitit.

Lidhur më këtë çështje zyrtarët përgjegjës na informuan se pajisjet nuk ishin dorëzuar nga zyrtarët cilët tani më nuk janë pjesë e institucionit.

Ndërsa mos largimi i pasurive të tjetërsuara dhe mos kalkulimi i shpenzimeve të zhvlerësimit, ishte rezultat i problemeve me sistemin E-pasuria, ky problem është shpalosur në PFV e vitit 2021.

Ndikimi Kontrollet e dobëta në menaxhimin e pasurisë kanë rezultuar me mangësi në këtë komponent të cilat e rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre, si dhe mos zhvlerësimi i pasurive ndikon në mbivlerësimin e tyre dhe në prezantim jo të drejtë të gjendjes së pasurive në pasqyrat vjetore financiare.

Rekomandimi A3 Avokati I popullit duhet të hartoj një rregullore të brendshme për menaxhimin e pasurisë dhe t'i rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja dhe keqpërdorimi i tyre si dhe të mirëmbahen regjistrat e pasurisë duke aplikuar zhvlerësimin tyre duke siguruar raportim të drejtë të gjendjes së tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,269,279	1,188,993	1,134,292	1,054,732	1,143,429
Grante Qeveritare - Buxheti	1,269,279	1,175,418	1,134,292	1,054,732	1,124,234
Donacionet e jashtme	0	13,575	0	0	19,194

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 80,286€. Buxheti fillestar është zvogëluar 43,000€ për deklaram të kursimeve buxhetore, dhe 50,861€ me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2021 IAP ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 1,134,292€, me një rritje 2% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,269,279	1,188,993	1,134,292	1,054,732	1,143,429
Pagat dhe mëditjet	982,851	947,571	947,571	918,586	942,935
Mallrat dhe shërbimet	258,928	231,514	182,213	94,308	195,231
Komunalitë	15,000	4,908	4,508	3,488	5,263
Investimet Kapitale	12,500	5,000	0	38,350	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë: (Përshkrimet të renditen konform radhitjes në tabelën e mësipërme)

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar me vendim të Qeverisë nr.11/52 të dt.29.12.2021 në vlerë 35,280€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i dorëheqjes së një zëvendës avokati dhe katër raste tjera që kishin të bënin me pushime të lehonisë. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 947,571€;


• Buxheti final për mallra dhe shërbime (pa donacione) në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 40,989€. Zvogëlimi ka ndodhur si rezultat i kursimeve buxhetore në vlerë 30,000€ dhe me vendim të Qeverisë nr.11/52 të dt.29.12.2021 dhe nr.21/50 të dt.23.12.2021 në total 10,989€. Buxheti për këtë kategori është zvogëluar pasi që disa aktivitete ishin financuar nga projekti IPA, gjithashtu kishin mbetur edhe aktivitete tjera të pa realizuara për shkak të situatës pandemike. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 182,212€

• Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për vlerën 10,092€. Ky zvogëlim ishte bërë 8,500€ për kursime buxhetore dhe me vendim të Qeverisë nr.21/50 të dt.23.12.2021 në vlerë 1,592€. Shpenzimet komunale përfshijnë shpenzimin e telefonisë fikse si dhe të energjisë elektrike për zyrën regjionale në Graçanice. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 4,507.91€;dhe

•Buxheti final për Investime Kapitale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për vlerën 7500€. Me deklarime për kursime buxhetore ishte zvogëluar për 4,500€ dhe me vendim të Qeverisë nr.21/50 të dt.23.12.2021 në vlerë 3,000€. Për projektin "Furnizim me pajisje teknike dhe softverike të teknologjisë informative" në shumë 12.500€ dhe si i tillë është pasqyruar edhe Programin e Investimeve Publike (PIP 2021). Projekti ka dështuar për faktin pasi që për tre herë është dhe asnjëherë nuk ka janë pranuar oferta nga operatorët ekonomik.

• Buxheti final është rritur në vlerë 13,575€ nga donacionet, të cilat IAP I kishte pranuar në vitin 2015. Këto donacione për t'u shfrytëzuar fillimisht duhet të paraqiten projekte nga IAP dhe më pas të aprovohen nga donatorët. Në mungesë të projekteve deri më tani ky buxhet prej viti në vit mbetet i pa shpenzuar.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga kthimi i mjeteve në vitin 2021 ishin në vlerë 177€. Ato kanë të bëjnë për shumën e shërbimit të pa kryer të pastrimit të zyreve regjionale të IAP të kontraktuar me OE për shërbime pastrimi.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	177		
Të hyrat tjera	0	0	177		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 nuk ka rezultuar me as një rekomandim.


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Shemsije Llugiqi, Udhëheqëse e ekipit



Ganimete Dalloshi, Anëtare e ekipit



Mazlumsha Sejfadini, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë,
28 prill 2022

LETËR E KONFIRMIMIT
Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

E/! nderuar,

Përmes kësaj shkrese, ju njoftoj dhe konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2021, (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Paraprakisht, ju faleminderit për mirëkuptim dhe bashkëpunimin tuaj.

Me nderim,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

Rr. R. D. Mijani, nr. Nr. 21 • 10000 • Prishtinë/Prishtina • Kosovo/Kosovo
Tel: +383 (0) 38 225 782, 223 783, 223 784 • Fax: +383 (0) 38 223 790
www.ombudsmankosovo.org • info@ombudsmankosovo.org

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.